VENDIM
Nr.551 datë 8.11.1993

PËR LEJIMIN E PAGESËS SË PENSIONIT TË PLEQËRISË PËR PENSIONISTËT E PUNËSUAR OSE TË VETËPUNËSUAR NË SEKTORIN PRIVAT

Në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejohet pagesa e pensionit mujor të pleqërisë për pensionistët pas daljes në pension punësohen ose vetëpunësohen në sektorin privat.
2. Pensionistët e punësuar ose vetëpunësuar në sektorin privat derdhin kontribut sipas dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë kohës që marrin pensionin.
3. Nuk njihet vjetërsi pune për efekt të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", koha që pensionistët marrin pension.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 tetor 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi